



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

RREGJISTRI I KËRKESAVE PËR INFORMACION

Periudha Janar-Mars 2025

Nr rendo r (1)	Data e kërkesës (2)	Objekti i kërkesës (3)	Data e përgjigjes (4)	Përgjigje (5)	Mënyra e përfundimi t të kërkesës (6)	Tarif a (7)
1	07.01.2025	A ka patur ndryshime në projektin e Ujësjiellit të Himarës? Nëse po, ju lutemi na vini në dispozicion një kopje të projektit të ndryshuar; Në çfarë faze ndodhen punimet për ndërtimin e Ujësjiellit të Himarës?	05.03.2025	Pershendetje, Pika 1 Ne përgjigje të pyetjes të dërguar nga ana juaj, Ujësjielli i ri që po ndërtohet në zonën e Himarës ka patur ndryshime për shkak nga dita që është projektuar në zonën e Himarës janë ndërtuar shumë objekte të reja, të cilat nuk janë parashikuar në projekt dhe në zbatim të projektit këto objekte janë shtuar për furnizim me ujë. Pika 2 Po ju bashkëngjijmë një kopje të projektit për zonën e Himarës. Pika 3	Përfunduar	Jo

				Ujesjellesi i ri i Himares i cili po ndertohet ne zonen e Himares eshte ndare ne 2 Lote. Loti 1 dhe Loti 2. Loti 1 perfshin linjen kryesore te tubacionit nga zona e burimit Lepushes deri ne Vublo(Pilur), e cila ndodhet ne fazen 75% te punimeve. Loti 2 perfshin furnizimin me uje per zonat Himare, Borsh, Livadh, Vuno, Jal, Himare Fshat, Kudhes dhe Pilur e cila ndodhet ne fazen 82% te punimeve. Me poshte eshte paraqitur nje tabele me e detajuar per cfare eshte shprehur tek email-i. Faleminderit. Ujesjellesi Kanalizime Himare.		
2	16.01.2025	1. Cilët ishin aktivitetet kryesore festive të organizuara nga Bashkia Himarë gjatë fundvitit (p.sh., evente, koncerte, apo aktivitete kulturore)? 2. A u përfshinë artistë lokalë, kombëtarë apo ndërkombëtarë në këto aktivitete? Nëse po, cilët ishin ata?	29.01.2025	Aktivitetet e fundvitit, Himarë 2024 Në kuadër të festimeve të fundvitit, gjatë muajit dhjetor, Bashkia Himarë organizoi një sërë aktiviteteve festive për të krijuar një atmosferë gëzimi dhe për të bashkuar	Përfunduar	Jo

		3. A u organizuan aktivitete të veçanta për fëmijë, të moshuar apo grupe të tjera të komunitetit? 4. Sa ishte pjesëmarrja e komunitetit lokal në këto aktivitete? 5. A pati bashkëpunime me institucione, shoqata, apo organizata të tjera për realizimin e këtyre aktiviteteve? 6. Sa ishte kostoja totale për organizimin e këtyre aktiviteteve festive? Ju lutem, nëse është e mundur, përfshini edhe ndarjen e shpenzimeve kryesore (p.sh., për koncerte, organizim, artistë, etj.).		komunitetin. Këto aktivitete synonin të ofronin argëtim, ndërveprim social-kulturor dhe një frymë festive për të gjithë. Qëllimet kryesore të aktiviteteve ishin: Promovimi i Himarës si një destinacion turistik gjatë gjithë vitit, jo vetëm në verë. Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore në komunitet. Zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe argëtuese për fëmijët. Aktivitetet kryesore festive:  Shfaqje filmash për fëmijë Një program i dedikuar për fëmijët, ku ata patën mundësinë të shijonin filma vizatimorë të përzgjedhur. Aktiviteti u zhvillua për katër ditë rresht në sallën "Neço Muko" pranë Bashkisë Himarë, me dy filma në ditë – filma vizatimorë në mëngjes dhe filma për grupmoshën 10+ pasdite.	
--	--	--	--	---	--

				🎭 Shfaqja teatrale "Gruaja e Burrit Tim" Një eksperiencë unike kulturore për publikun himariot, me regji të Kiço Londos. Shfaqja solli një atmosferë të veçantë për artdashësit e qytetit. 🎵 Koncert festiv me këngë dhe valle nga fëmijët e shkollës 9-vjeçare Nxënësit e kopshtit dhe shkollës 9-vjeçare "Pano Meniko" performuan me këngë, valle dhe recitime në sallën "Neço Muko", duke krijuar një atmosferë të ngrohtë festive për prindërit dhe komunitetin. 🎄 Christmas PotFest Himara Një festival që promovoi trashëgiminë kulturore shqiptare dhe Himarën si destinacion turistik. Event i solli: Ekspozita artizanale me produkte "Made in Albania". Prezantim të vlerave tradicionale në artizanat,		
--	--	--	--	--	--	--

				tekstile, qëndisje, pirografi dhe kostume popullore. Shfaqje me këngë dhe valle nga grupet polifonike të Himarës dhe Pilurit, si dhe artistë të njohur kombëtarë. Shpërndarje dhuratash për fëmijët nga Babagjyshi i Vitit të Ri. ✦ Eventi i ndezjes së dritave për Vitin e Ri Një aktivitet simbolik ku fëmijët e shkollës 9-vjeçare përgatitën një program me recitime dhe kërcime. Kryetari i Bashkisë ndezi dritat festive të qytetit, ndërsa atmosfera u mbush me muzikë dhe performanca nga DJ. 🦀 Fishekzjarret e ndërrimit të viteve Himara u zbukurua me një spektakël madhështor fishekzjarresh, duke ndriçuar qiellin e qytetit në natën e ndërrimit të viteve.		
--	--	--	--	--	--	--

				Pjesëmarrja dhe ndikimi në komunitet Festimet përfshinë artistë lokalë dhe kombëtarë, duke krijuar një program të larmishëm për të gjithë komunitetin. Shfaqjet dhe koncertet ishin të hapura për të gjithë, duke ofruar mundësi për të shijuar artin dhe kulturën. Përveç të rriturve, edhe fëmijët ishin në qendër të vëmendjes me aktivitete të dedikuara për ta. Këto evente festive forcuan identitetin kulturor të Himarës dhe krijuan një hapësirë për bashkëpunim, gëzim dhe shpresë për vitin e ri.		
3	29.01.2025	Qendra Res Publica është e angazhuar ti shërbejë publikut për të bërë transparencën e institucioneve e cila ndikon drejtëpërsëdrejti në mirëqeverisjen e vendit. Në shërbimin online www.publeaks.al ka mbërritur kërkesa e një qytetari për tu informuar në lidhje me: –Kopje të dokumentacionit shoqërues të vendimit Nr. 34, Prot.1021/1, datë 30/3/2022“Leje infrastrukture”, konkretisht:	10.03.2025	Në përgjigje suajës Nr.753/1prot, datë 26.02.2025, protokolluar me tonën Nr.1957prot, datë 27.02.2025 marrë në dorëzim më 03/03/2025 me anë të së cilës ju kërkon informacion dhe koje të dokumentacionit në bazë të	Përfunduar	Jo

	-Preventivi i punimeve, -Plani i vendosjes se strukture, -Grafiku i punimenve -Miratim për VNM paraprake, -Raport i VNM , -Raporti teknik, -Deklarata e projektuesit të licencuar inxhinier mjedisi, -Leje perdorimi burimi uxor nga AMBU, -Marveshje investimi RËSP IV, - Oponeca teknike e projektit, -Relacion teknum RËSP IV Lo, -Harta hidrogeologjike, -Prerja hidrogeologjike, -Planimetria e kaptazhit Burimi i Lepushes, -Studim hidrogeologjik, -Vendimi dhe Oponenca e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar, -Marveshje paraprake investimi Bashkia Himare dhe FSHZH, -Projekti teknologjik,		kërkesës së qendrës “Res Publica”, ju informojmë: Në lidhje me çështjet e ngritura për informimin në lidhje me vendimin nr.34,prot.1021/1, datë 30/03/2022 “Leje Infrastruktura” për objektin “Ndërtimi i linjës kryesore të Ujësjetës Himarë”, ju bëjmë me dije: Çështja për të cilën kërkoni informacion është duke u gjykuar e pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, në gjykimin e padisë Nr.2616akti., me palë; Paditës: 1. Pesëdhjetë e katër banorë të njësisë administrative Brataj. Kuc, etj. 2.Qendra“Eko Albania”, regjistruar me vendimin nr, 4040, datë 15.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NUIS: L424234520, me adresë: Rr. “Sali Butka”,	
--	---	--	--	--

		-Deklarata e projektuesit të licencuar inxhinier hidroteknik, -Licensa profesionale, -Polica e sigurimit te projektit, -Autorizimin pere aplikuesin, -Dokument vertetues per pronat publike te shtrirjes se projektit, -Raport mbi impaktin social dhe ambiental, -Formati i aplikimit, i nënshkruar elektronikisht		Objekti TBM construction 2016 shpk, AP, 24, kati 4, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z. Olsi Nika. Të gjithë të përfaqësuar nga Av. Irena Dule, me licencë nr.1969 me adresë për efekt njoftimesh Blv. “Gjergj Fishta”, Nd. 24, H. 3, AP. 7, Tiranë, email: irenedule@gmail.com, tel. 0682047471. Të paditur: 1.Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me adresë: Rr. "Sami Frashëri" Tiran 2.Bashkia Himarë 3.Këshilli i Basenit Vjosë, Vlorë. Me objekt; 1.Shfuqizimin e Vendimit për VNM Paraprake AN030320210005, Komisioni 20,datë 05.05.2021, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.		
--	--	--	--	--	--	--

				2.Shfuqizimin e Vendimit nr. 4, datë 09.12.2021, të Këshillit të Basenit Vjosë, “Për miratimin e kërkesës për leje për përdorimin e burimit ujqor nëntokësor për ujë të pijshëm të Bashkisë Himarë”, me vendndodhje: Bashkia Himarë, Qarku Vlorë. 3.Shfuqizimin e Vendimit Nr. 34, datë 30.03.2022, të Bashkisë Himarë, leje infrastrukture për objektin “Ndërtimi i linjës kryesore të ujësjellsit Himarë”. 4.Shfuqizimin e Vendimit Nr. 115, datë 16.09.2022, të Bashkisë Himarë, leje infrastrukture të objektit “Sistemi i Furnizimit me Ujë të Himarës, Lidhja e Linjës Kryesore të Dërgimit me sistemin e furnizimit me ujë të fshatrave Pilur, Kudhës, Himarë, Livadh dhe Jalë si dhe Rrjeti i brendshëm i Ujësjellësit të këtyre fshatrave”.		
--	--	--	--	---	--	--

				5.Shfuqizimin e Vendimit Nr. 119, datë 22.09.2022, të Bashkisë Himarë, leje infrastrukturore për ndërtimin e objektit “Rrjeti KUN Himarë, dhe Stacione Pompimi”. 6.Shfuqizimin e Vendimit Nr. 162, datë 01.12.2022, të Bashkisë Himarë, leje infrastrukturore për ndërtimin e objektit “Lidhja e linjës kryesore të dërgimit me sistemin e furnizimit me ujë të fshatrave Vuno, Himarë Fshat, rrjeti i brendshëm i Ujësjiellit të këtyre fshatrave, si dhe rrjeti i brendshëm i Ujësjiellit të Borshit”. 7.Shfuqizimin e Vendimit Nr.163, datë 01.12.2022, të Bashkisë Himarë, lejes infrastrukturore për ndërtimin e objektit “Rrjeti KUN Himarë fshat, dhe Stacione Pompimi”, në Bashkinë Himarë.		
--	--	--	--	--	--	--

				Përsa më sipër duke kërkuar ndjesë për vonesat për shkak të mungesës së personelit dhe ngarkesës së shtuar të kësaj periudhe parapërgatitore për sezonin turistik, jeni të mirëpritur të bëheni pjesëmarrës në gjykimin e padisë nr. 2616akti.		
4	13.03.2025	Kopjet e vendimeve të Këshillit Bashkiak të brenda peridhuës 11 Janar-11 Mars 2025	20.03.2025	Përsëritet, Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 11.03.2025, e administruar pranë institucionit tonë më 13.03.2025, ku kërkohet "Kopjet e vendimeve të Këshillit Bashkiak të miratuara brenda periudhës 11 Janar - 11 Mars 2025" pranë Bashkisë Himarë, po ju dërgojmë linkun ku publikohen vendimet e Këshillit Bashkiak të Himarës. Bashkëngjitur gjeni linkun përkatës: https://www.vendime.al/?search=	Përfunduar	Jo

				class=DB_CustomSearch_Widget-db_customsearch_widget&widget_number=preset-default&cs--0=HIMARE&cs-Viti-1=&cs-Muaji-2=&cs-Numri_i_vendimit-3=&search=Kerko Faleminderit për mirëkuptimin!		
5	20.03.2025	1-A ka pasur Bashkia juaj buxhet vjetor të planifikuar për rininë (grup moshën 15-29 vjeç) për periudhën janar- dhjetor 2024? Nëse po , sa përqind e totalit të buxhetit zënë këto zëra? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka një planifikim të tillë? 2. Sa është numri total i punonjësve në Bashkinë tuaj (2024)? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë? 3- Sa është numri i të rinjve (18-29) punonjës të bashkisë tuaj në vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin	26.03.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 20.03.2025 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj: 1-Po edhe në bashkinë tonë, është një zë në buxhet e dedikuar për rininë e cila zë 1.18% të totalit të buxhetit të përgjithshëm të bashkisë.	Përfunduar	Jo

	personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë? 4- Sa është numri i të rinjve (18-29) të punësuar në bashkinë tuaj, të cilët mbajnë pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse? (zv.kryetar, drejtor, etj). Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë? 5- A Bashkia politika rinore te zhvilluara specifikisht per grup moshat 15-29 vjeç? Nese jo, ju lutem mund te na tregoni disa nga arsyet persenuk ka te zhvilluar nje politike te tille? 6- A keni në institucionin tuaj, drejtori, sektorë, staf të dedikuar për rininë? Prej sa kohësh janë funksionale? 7-A ka struktura rinore te ngritura në Bashkinë tuaj dedikuar grupmosha së të rinjve 15-29 vjeç(qendra, zyra rinore,këshilla rinore,parlament rinor,struktura konstruktive rinore,etj) për periudhën janar-dhjetor 2024 nëse po,cilat janë ato? 8-Me kë keni bashkëpunuar për ngritjen e strukturave të tilla (organizata rinore, grupe të rinjsh,individë etj.)	2-Numri total ishte 222, nga keta 78 femra dhe 144 meshkuj. Persona me aftesi te kufizuar 0. 3-Numri total ishte 30, nga keta 9 femra dhe 21 meshkuj. Persona me aftesi te kufizuar 0. 4-Asnjë të punësuar . Persona me aftesi te kufizuar 0. 5-Një nga politikat e ndjekura për aktivizimin e të rinjve të Bashkisë Himarë është krijimi i Këshillit Rinor, që është specifikisht aktiv për problematikat rinore, edhe per këtëvit nuk kemi, organizata të tjera rinore ose grupe vullnetare,kjo për shkak edhe të numrit të ulët që ka në territorin e bashkisë sonë. 6-Kemi një punonjës te emëruar për rininë "Specialist i arsimit dhe rinisë", ky pozicion është formuar në vitin 2021.		
--	---	--	--	--

	9- A keni një plan veprimi për Këshillin Rinor Vendor? Sa aktivitete janë organizuar nga KVR përgjat 2024? 10- Për çfarë lloj mbështetje/iniciative/bashkëpunime keni nevojë për të përmirësuar funksionalitetet e KVR në qytetin tuaj? 11- Sa të rinj janë të përfshirë në KVR? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin persnave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë? 12- A keni pasur ju forma të tjera bashkëpunimi (me grupe të rinjsh,organizata rinore, individë etj). 13-Sa është me përafërsi pjesëmarrja e të rinjve në konsultimet publike të zhvilluara nga bashkia? Cilat janë disa nga mjetet apo mekanizmat që përdor bashkia në përfshirjen e të rinjve në të tilla procese? 14- Lutemi listoni mjetet e komunikimit që përdor bashkia juaj dhe link përkatëse të faqes së webit të bashkisë.		7-Ne kemi një person të dedikuar për çështjet e rinisë pranë bashkisë sone i cili eshte specialist i arsimit dhe rinise, pjese e drejtorisë së çështjeve sociale,arsimit dhe rinisë, strukturë tjetër është Këshilli Vendor Rinor, momentalisht nuk ka një qendër riore apo zyrë dedikuar vetëm rinisë. 8-Bashkëpunimi jonë për çështjet e rinisë është kryesisht me të gjitha shkollat e Bashkisë sonë dhe më shumë me gjimnazet. 9-Po kemi të parashikuar një sër aktivitetesth që janë për tu zhvilluar gjatë këtij viti, gjatë vitit 2024 nga KVR janë organizuar aktivitete informuese, ndergjegjësuere nëpër të gjitha shkollat. 10-Po kemi nevojë për një grup ekspertësh trajnimi, që të vinë në qytetin tonë dhe bashkë me		
--	--	--	---	--	--

	15. Sa është numri total i përfituesve nga Skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 16. Sa është numri e të rinjve (15-29 vjeç) përfitues nga Skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 17. Sa është numri total i përfituesve të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 18. Sa është numri e të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 19. Sa është numri total i personave të cilat janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? 20. Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) të cilat janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2024? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?		Këshillin Rinor të, tju vinë në ndihmë për të hedhur disa ide konkrete të realizueshme për të fuqëzuar këtë këshill. 11-Këshilli Rinor është i përbërë nga 5 anëtarë por jemi në pritje të emërimeve të tjera pasi kemi bërë thirrjen, janë 4 femra dhe një mashkull dhe nuk kemi asnjë person me aftësi të kufizuara. 12-Po kemi pasur një bashkëpunim me kordinatoren e Bashki të Forta, si dhe me punonjës të bashkive të tjera. 13-Pjesëmarrja e të rinjve në konsultimet publike të zhvilluara nga Bashkia janë përafersisht rreth 20%. Disa nga mjetet apo mekanizmat që përdor bashkia në përfshirjen e të rinjve në të tilla procese janë njoftimet që publikohen te këndi i afishimeve pranë bashkisë si dhe rrejtet sociale.	
--	--	--	---	--

				14-Webi i bashkisë:https://himara.gov.al/ Emri facebook: Bashkia Himarë: https://www.facebook.com/profile.php?id=61568448545302 Instagram: bashkiahimare: https://www.instagram.com/bashkiahimare?igsh=ajJyYnJvbGxjbmg5 15-Familje me NE ne total janw 63 , femra 14 meshkuj 49. 16-Mosha (15-29)vjeç totali 17 persona , femra 9 dhe meshkuj 8. 17-Numuri i personave me aftesi te kufizuar totali 146 , femra 71 meshkuj 75. 18-Numri total i te rinjeve (15-29) gjithsejt 13, femra 5 dhe meshkuj 8. 19-Nuk kemi sherbime.		
--	--	--	--	--	--	--

				20-Nuk kemi sherbime.		
--	--	--	--	-----------------------	--	--

Shënim:

1-Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

2-Data e regjistrimit të kërkesë

3-Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

4-Data e kthimit të përgjigjes

5-Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

6-Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

7-Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.